



Npi – 01/95 datë: 31.03.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.03.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 31.03.2021, (e mërkurë) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat të gjithë, Zyrtarja Kryesore Financiare znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për Informim, z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OJQ-së "YAGR" z.Bekim Krasniqi, Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha, Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 04.03.2021,
2. Pyetje – Përgjigje,
3. Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit, Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
4. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba, sipas rekomandimit të MPL-së,
5. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2020 në vitin 2021,
6. Propozim për ndryshimin e Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë,
7. Propozim-Vendim për vazhdimin e Komisionit në përzgjedhjen e drejtorëve e zv.drejtorëve,
8. Draft-Statuti i ri i QKMF-së "Vezir Bajrami" në Shtime,
9. Informatë për aktivitetet e Zyrës së Prokurimit për vitin 2020,
10. Informatë nga DKRS-së.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fillimisht ftoi anëtarin e re të Kuvendit znj.Arbenita Halimi që të jep betimin para Kuvendit.

znj.Arbenita Halimi; Doli në foltore, dhe lexoi tekstin e betimit të paraparë me nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040,

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi i uroi mirëseardhje znj.Arbenita Halimit dhe punë të mbarë hapi diskutimin për rendin e ditës.

Lidhur me rendin e ditës diskutuan: z.Reshat Mujota, z.Besnik Seferi, z.Fehmi Hysenaj, z.Ruzhdi Jashari, z.Isak Musliaj, z.Reshat Mujota, z.Fehmi Hysenaj, z.Rexhep Gashi, z.Naim Zejna.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”** aprovet rendi i ditës i propozuar nga Kryesuesja e Kuvendit, prej 10 pikave.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 04.03.2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 18 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”** aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 04.03.2021.

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pyetje kanë parashtruar: z.Shefki Dauti, z.Fehmi Hysenaj, z.Skender Hyseni, z.Isak Muslija, z.Ruzhdi Jashari, znj.Valentina Halili-Ferati, znj.Adelina Beqaj, z.Reshat Mujota, z.Naim Zejna, z.Besnik Seferi, z.Rexhep Gashi.

Nga ekzekutivi diskutuan: znj. Kimete Ukaj (ZKF), z.Lumni Amrush (Drejtor i DKRS), znj.Shqipe Rexhaj (Drejtoreshë e DPUKGJ), z. Muhadin Halili (Drejtor i DPP), znj.Agime Roshaj (Drejtoreshë e DKA), z.Hamëz Tërshani (Drejtor i DSHP).

Pika 3

Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit, Npi-01/272, të datës 24.11.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Për këtë pikë diskutuan: z. Reshat Mujota, z.Isak Muslija (2 herë), z.Fehmi Hysenaj (3 herë), z.Naim Zejna (2 herë) z.Perparim Ramusa, z.Ruzhdi Jashari (2 herë), znj.Adelina Beqaj, z.Shefki Dauti (2 herë).

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”** vendosi që pika e tretë të rendit të ditës “Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit, Npi-01/272, të datës 24.11.2020” të shtyhet për shqyrtim.

Pika e 4

Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha, sipas rekomandimit të MPL-së

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;Para se të hapë diskutimin fjalën ja dha Kimete Ukaj, për prezantimin e kësaj pike.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Ka dhënë sqarime lidhur me këtë pikë, se MPL ka dhënë vërejtje në disa nga nenet e kësaj rregullore, të cilat ne duhet të përmirsojmë. Dokumentin e kenë marrë me kohë, drejtorët janë të njoftuar dhe i kanë bërë korigjimet e nevojshme. Nëse ka pyetje une do të përgjigjem.

Për këtë pikë diskutuan:z.Ruzhdi Jashari, znj.Zarife Rexhaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Dha sçarime në pyetjet e antarëve të Kuvendit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuqorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, Npi – 01/17 datë: 28.01.2021, si vijon:

1. Te Neni 3.1.2 në vend të fjalëve “Ekstrakti i Lindjes” zëvendësohen me fjalët “Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile”.
2. Te Neni 3.1.4 në vend të fjalëve “Certifikata e martesës (kurorëzimit)” zëvendësohen me fjalët “Çertifikatë e martesës” .
3. Te Neni 3.1.5 në vend të fjalëve “Certifikata mbi statusin martesor” zëvendësohen me fjalët “Çertifikatë e gjendjes martesore” .
4. Te Neni 3.1.8 në vend të fjalëve “Certifikatë e nënshtetësisë” zëvendësohen me fjalët “Çertifikatë e Shtetësisë” .
5. Te Neni 3.1.9 në vend të fjalëve “Certifikatë mbi vendbanimin” zëvendësohen me fjalët “Çertifikatë e vendbanimit” .
6. Te Neni 3.1.10 në vend të fjalëve “Dëshmi vdekjeje” zëvendësohen me fjalët “Dëshmi e vdekjes” .
7. Pas Nenit 3.2.5 shtohet neni i ri 3.3 ku thuhet “Bazuar në nenin 63 të Ligjit për Gjendjen Civile, Nr.04/L-003, Me gjobë denohet personi që bën këto shkelje”:
8. Në vazhdim shtohet neni i ri 3.3.1 ku thuhet “Me gjobë në vlerë prej 20.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk paraqet lindjen e fëmijes në afatin e paraparë me ligj”.
9. Në vazhdim shtohet neni i ri 3.3.2 ku thuhet “Me gjobë në vlerë prej 50.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas ligjit”.
10. Bazuar në rekomandimet nga MEA-AKK, në Prishtinë, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores Komunale për taksa, tarifa dhe gjoha për vitin 2021, Nga rregullorja fshihen komplet nent: “ Nga neni 6 deri te neni 6.16.10 “.
11. Nga rregullorja fshihet neni: “10.1.8 Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës 3.00 €” .
12. Nga rregullorja fshihet neni: “10.1.9 Vërtetim për praninë të shtetësisë së Republikës së Kosovës 2.00 €” .
13. Te Neni 10.2.18 në vend të fjalëve “Certifikata mjekësore e leshuar sipas kërkeses së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore 15.00 € ” zëvendësohen me fjalët “Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Çertifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, bëhet lëshimi i Çertifikatave të shëndetësisë në Kujdesin Primar” .
14. Shtohet neni i ri 10.2.18.1 ku thuhet “Çertifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim (Lirohen nga pagesa në sektorin publik, bazuar në Ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj).....10€ ” .
15. Shtohet neni i ri 10.2.18.2 ku thuhet “Çertifikata shëndetësore për punësim.....15€ “ .
16. Te Neni 13 në vend të fjalëve “Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, për personat fizik, marrjen e lejes për shfrytëzim. Ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtjes me gjobë ” zëvendësohen me fjalët: “Mos pagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, marrjen e lejes për shfrytëzim për personat fizik. Ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtjes me gjobë sipas ligjit për kundërvajtje Nr 05/L-087 ” .
17. Te baza Ligjore në fillim të rregullores në vend të fjalëve: “ Bazuar në nenin 12.2. pika (c) dhe nenin 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Veteqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe duke marrë për bazë nenet 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës “ zëvendësohen me fjalët: “ Bazuar në nenin 12.2. pika (c) dhe nenin 40.2 pika (g)

të Ligjit mbi Veteqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenet 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Nenin 23 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Neni 15 (pika f), të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025; Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr.01/2017; Rregulloren e MAPL-së për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës Nr.01/2017.

Pika 5

Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2020 në vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Kimete Ukaj, për prezantimin e kësaj pike. **znj.Kimete Ukaj, ZKF;** Sqaroi kodet dhe programet për bartjen e mjeteve e mbetura, në vazhdim specifikoj shumat e mbetura për projekte të caktuara. Dokumentin e keni marr në formë të shkruar dhe nëse ka pyetje do të përgjigjem.

Për këtë pikë diskutuan: z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj (2 herë), z.Ruzhdi Jashari (2 herë), z.Isak Muslija z.Shefki Dauti (2 herë), z.Muhamet Ademaj (2 herë), z.Rexhep Gashi, z.Besnik Seferi (2 herë).

Në pyetjet e antarëve të kuvendit u përgjigjen: znj.Kimete Ukaj (Drejtoresh ZKF), znj.Agime Roshaj (Drejtoresh e DKA).

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për”, me 2 vota “Kundër”, dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi Vendimin për ndarjen e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2020, në vitin 2021.

Pika 6

Propozim për ndryshimin e Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Agime Roshaj, për prezantimin e kësaj pike. **znj.Agime Roshaj, Drejtoreshë e DKA;** Unë i rekomandojë Kuvendit aprovimin e vendimit për ndryshimin e rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentë.

Ndryshimet që i kemi propozuar i kemi marrë në formë të shkruar, mendojë se nuk ka nevojë që ti lexojë prap por nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

Për këtë pikë diskutuan: znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari (2 herë), z.Shefki Dauti (2 herë), z.Rexhep Gashi, z.Besnik Seferi.

znj.Agime Roshaj, Drejtoreshë e DKA; Dha sqarime në pyetjet e antarëve të Kuvendit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për”, me 3 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për ndarjen e bursave për studentë, 01nr.06/570-60 të datës 30.03.2012, si vijon:

1. Në Rregullore, shkurtesa “DAKRS” përmirësohet me shkurtesën “DKA”.
2. Te neni 2 shtohet pika 2.2 ku thuhet: “ Kuvendi me vendim cakton sasinë e bursave për vitin akademik, sipas drejtimeve prioritare (deficitare) fakulteteve të cilët i propozon – cakton DKA”.
3. Te neni 5 shtohet pika 5.2 ku thuhet: “Drejtimit prioritare (deficitare) të fakulteteve, i cakton DKA, referuar nenit 2.2 “ .
4. Te neni 10.3. ku bëhet fjalë për Konkursin, i cili përveq pikave tjera shtohet edhe pika 10.3 pika (d) ku thuhet “ Profilet prioritare (deficitare), numri i bursave, sipas fakulteteve përkatëse, të përcaktuara në nenin 2.2” .

Pika 7

Propozim-Vendim për vazhdimin e Komisionit në përzgjedhjen e drejtorëve e zv.drejtorëve
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Agime Roshaj, për prezantimin e kësaj pike.

znj.Agime Roshaj, Drejtoreshë e DKA; Dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke propozuar që ti vazhdohet mandati komisionit në përbërje të njejtë.

Për këtë pikë diskutuan: z.Reshat Mujota.

znj.Agime Roshaj, Drejtoreshë e DKA; Dha sqarime në pyetjen e z.Reshat Mujota.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi Vendimin për vazhdimin e mandatit të Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar sipas kriterëve të Konkursit në postin e Drejtorit, përkatësisht Zëvendës-Drejtorit, në Institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes, për të gjitha konkurset që do të shpallen gjatë vitit shkollorë 2020/2021 përkatësisht deri më 31 Gusht 2020, si vijon:

Anëtar i Komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga DKA:

1. Fatmir Zymeri – Zyrtar për Arësim,

Anëtar i Komisionit nga Këshilli i Prindërve të Nxënësve në Komunën e Shtimes:

2. Basri Hyseni – Kryetar i Këshillit të Prindërve.

Anëtar i Komisionit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – Prishtinë:

3. Një antarë e dërgon Ministria.

Pika 8

Draft-Statuti i ri i QKMF-së “Vezir Bajrami” në Shtime

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 31.03.2021, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Statutin e ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “ Dr. Vezir Bajrami ” në Shtime, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

Pika 9

Informatë për aktivitetet e Zyrës së Prokurimit për vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Muhadin Halili, për prezantimin e kësaj pike.

z.Muhadin Halili, Drejtor i DPP; ; Dha sqarime lidhur me këtë pikë, dhe në vazhdim tha se informatën e keni marr në formë të shkruar, prandaj meqenëse jeni lodhur nuk po e shoh të arsyeshme që ta lexojë krejt informatën, mirpo nëse ka pyetje unë do të përgjigjem.

Pika 10

Informatë nga DKRS-së

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Lumni Amrushi, për prezantimin e kësaj pike.

z.Lumni Amrushi drejtor i DKRS; Përshendetje, meqenëse informatën e keni marrë me kohë në formë të shkruar, unë nuk kamë çka ti shtojë më shumë, asaj që është e shkruar.

Po besojë që informatën e keni lexuar, dhe pò presë nëse keni ndonjë pyetje jamë i gatshëm që të përgjigjem.

Për këtë pikë diskutuan: z.Rexhep Gashi, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Jashari.

z.Lumni Amrushi drejtor i DKRS; U përgjigj pyetjeve të antarëve të Kuvendit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 13.⁵⁶h.

Procesmbajtësi:

Ibrahim Demiri



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj

